



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 paragrafi g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsioni dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

Për miratimin e Planit të Integritetit

1. Miratohet Plani i Integritetit i Komunës së Prizrenit për periudhën 2024-2026, i hartuar nga Grupi Punues, i caktuar me Vendim nr. 048/2024 datë 12.02.2024.
2. Emine Gashi (zyrtare ligjore), caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit të Komunës së Prizrenit, për periudhën 2024-2026.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Arsyetim

Ky Vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), në raport me detyrimet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale për miratimin e Planeve të Integritetit.

Në kuadër të kësaj, sipas udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit të Metodologjisë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, kryetari i Komunës nxjerr vendim për miratimin e Planit të Integritetit, të hartuar nga Grupi Punues, i caktuar me Vendim nr. 048/2024 datë 12.02.2024, të theksuar si në pikën 1 të dispozitivit të vendimit.

Emine Gashi, sipas pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit, e cili monitoron procesin sipas planit të integritetit, zbatimin e masave të përmirësimit nga institucioni, përgatit treguesit për vlerësimin e efikasitetit dhe vlerësimin e rezultateve të masave të propozuara për përmirësimin e integritetit.

Nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

- Vendimi iu dërgohet:
- Grupit Punues,
- Personit përgjegjës,
- Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit,
- Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

